

Klik Ekspo Group nderon më Çmimin “Shqiponja e Artë” drejtorin e APD, Ing.
Eduard Ndreu.
01 Dhjetor 2011



Klik Ekspo Group nderoi me Çmimin “Shqiponja e Artë” drejtorin e Autoritetit Portual të Durrësit, Eduard Ndreu.

Dy ditë pas përfundimit të Panairit të 18-të, që qëndroi i hapur në kryeqytet për një javë radhazi, drejtuesit e këtij Grupi organizator ishin mbrëmjen e së enjtes në Durrës për të promovuar punën e portit më të madh të vendit.

Gjatë një ceremonie që u zhvillua në mjediset e këtij porti, presidenti i Klik Ekspo Group, Luan Muhametaj, tha se porti i Durrësit mbetet një pikë ndërlidhjeje e Shqipërisë me Ballkanin dhe Evropën.

Më pas ai lexoi motivacionin me të cilin Klik Ekspo Group akordon Çmimin “Shqiponja e artë” për z. Eduard Ndreu:

“Administrim me kompetencë të shkëlqyer profesionale të APD, angazhim në kryerjen e reformave dhe projekteve të zhvillimit, duke garantuar kthimin e portit të Durrësit në një nyje të sigurtë dhe të rëndësishme ndërkombëtare”.

Në fjalën e tij drejtori Ndreu tha se porti i Durrësit do të jetë gjithmonë në shërbim të biznesit.

“Thelbi i të gjithë rezultateve tona pozitive është partneriteti real me biznesin, si një nga elementët më të rëndësishëm në ekonomi-shtoi ai. “Me këtë Çmim nuk është vlerësuar vetëm drejtori, por edhe administrata dhe të gjithë ata që kanë punuar 24 orë radhazi në gjithë këtë periudhë”.

“Ne do të jemi të kujdesshëm që edhe në të ardhmen që biznesi të gjejë te porti një partner të besueshëm dhe serioz”-përfundoi fjalën e tij drejtori i APD, Eduard Ndreu.

Gjatë viteve të fundit në portin e Durrësit janë realizuar një sërë investimesh të rëndësishme. Sasia vjetore e përpunimit ka arritur në afro 3.5 milion ton mallra dhe 850 mijë udhëtarë me tragete.

